

Frosinone e Ajetit bie nga kategoria

nga Administrator
E diel, 08 Maj 2016 17:37



Arlind Ajeti e ka filluar nga minuta e pare ndeshjen per ekipin e tij Frosinone, por ekipi i tij ka humbur me rezultatin 1-0 kunder Sassuolo. Ajeti eshte aktivizuar per 90 minuta dhe ka zhvilluar nje ndeshje te mire por ekipi i tij ka qene i pafat. Me kete humbje ekipi i shqiptarit bie nga Seria A. Sezonin e ardhshem Frosinone do te luaje ne Serie B, por akoma nuk dihet ne qofte se Ajeti do te trasferohet tek nje ekip tjetër po i Serise A italiane apo do te luaje

Per 90 minuta eshte aktivizuar edhe mbrojtësi tjetër i kombetares Xhimshiti. Ne kete fund kampionati, tranjeri i ekipit te tij, Atalantes po i beson shqiptarit qendren e mbrojtjes. Kjo eshte ndeshja e dyte qe Xhimshiti luan si titullar per Atalanten.

Portieri i Lacios, Etrit Berisha, duket se nuk eshte ne planet e tranjerit te ri, Inzaghi, dhe vazhdon te jete zevendesues duke mos luajtur asnje minute. Ne merkaton e veres, pritët qe Berisha te trasferohet ne nje ekip tjetër ku mund te kete me shume mundesi aktivizimi.